

**L I G J**  
**Nr.8464, datë 11.3.1999**

**PËR STANDARDIZIMIN**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I :**

**KREU I**  
**PËRCAKTIME TË PËRGJITHSHME DHE PËRKUFIZIME**

Neni 1

Ky ligj vodos rregulla për procedurat e hartimit e të miratimit të standardeve shqiptare dhe për përcaktimin e statusit të tyre, akreditimit të laboratorëve të provave, organizmave certifikuese të produkteve, sistemeve të cilësisë, personelit dhe organizmave inspektues, certifikimit të produkteve, proceseve, shërbimeve dhe sistemeve të cilësisë dhe personelit, me qëllim që të sigurohet një nivel i caktuar cilësie, me përfashtim të rasteve kur në ligj përcaktohet ndryshe.

Neni 2

Në kuptimin e këtij ligji termat e mëposhtme kanë kuptimin që vijon:

Me "Standardizim" kuptohet veprimitaria për përcaktimin e standardeve, me mbështetjen dhe pjesëmarrjen e të gjithë atyre, që janë të interesuar dhe që ju përkasin.

Me "Standard" kuptohet një specifikim teknik, i miratuar nga organizmi kombëtar i standardizimit, për përdorim të vazhdueshëm, zbatimi i të cilit nuk është i detyrueshëm (përfashtuar periudhën e caktuar në nenet 11 dhe 16) dhe që shërben si dokument për arritjen e nivelit të caktuar të cilësisë.

Me "Akreditim" kuptohet procedura e dhënies së besimit specialistit, laboratorit të analizave, organizmit të inspektimit dhe të certifikimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), me qëllim që të njihen zyrtarisht kompetencat e tyre, në përmbrushjen e funksioneve të caktuara.

Me "Certifikim" kuptohet procedura e dhënies së markës së konformitetit dhe/ose të sigurisë, e cila kryhet nga një palë e tretë dhe e paanshme për vërtetimin e konformitetit të produkteve, proceseve, shërbimeve dhe sistemeve të cilësisë; sipas kërkësave të standardeve, specifikimeve teknike, kërkësave të tjera ose akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Me "Produkt" kuptohet çdo produkt i prodhuar në rrugë industriale dhe çdo produkt bujqësor.

Me "Markë konformiteti "Standard Shqiptar" (SSH), kuptohet një shenjë dalluese, e cila vendoset mbi një produkt ose mbi ambalazhin e tij, për të dëshmuar konformitetin e këtij produkti me standardin ose specifikimet teknike, të cilave u referohet.

Me "Deklaratë konformiteti" kuptohet një dokument, me të cilin prodhuesi deklaron, nën përgjegjësinë e vet personale, se një produkt, proces apo shërbim, i ofruar prej tij, është konform një specifikimi teknik.

Me "Rregulla teknike" kuptohen aktet nënligjore, me karakter teknik, të cilat përcaktojnë karakteristikat e produkteve ose proceset e prodhimit të tyre, ku përfshihen edhe masat administrative, që zbatohen për shkeljet e tyre. Ato mund të përbajnë edhe kërsesa që kanë të bëjnë veçanërisht me terminologjinë, simbolet, paketimin, marketimin ose etiketimin, kur këto kanë të bëjnë me një produkt ose proces prodhimi.

Me "Specifikime teknike" kuptohen specifikimet e dhëna në një dokument, të cilat jepin karakteristikat e kërkua të përfshirë edhe terminologjinë, simbolet, provat, metodat e analizave, paketimin dhe etiketimin e produktit.

Me "Sistem cilësie" kuptohet e gjithë struktura organizative, procedurat, proceset dhe burimet, që i nevojiten një subjekti për arritjen e cilësisë së kërkuar. Sistemi i cilësisë ndërtohet mbi bazën e serisë së standardeve ndërkombëtare, ISO 9000.

Neni 3

Ky ligj zbatohet nga të gjithë personat, fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë veprimitari ekonomike në Republikën e Shqipërisë.

**KREU II**  
**STANDARDET DHE RREGULLAT TEKNIKE**

Neni 4

Standardet shqiptare (SSH) kanë të njëjtën vlerë për të gjithë personat, fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë. Standardet shqiptare, ose pjesë të tyre, përdoren si bazë referuese për hartimin e rregullave teknike.

Standardi eksperimental përcakton kërkesat cilësore për prodhimet, ndërtimet dhe shërbimet e reja. Me përvetësimin e teknologjisë rishikohet për t'i dhënë atij statusin e Standardit Shqiptar. Standardi eksperimental nuk mund të merret si bazë referimi për hartimin e rregullave teknike.

DPS-ja i jep përparësi hartimit, përshtatjes, adoptimit dhe miratimit të një standardi, që shërben si bazë referimi për hartimin e një rregulli teknik, të nevojshëm për ekonominë shqiptare.

Standardet shqiptare janë të lira për t'u përdorur nga çdo person, fizik e juridik, që ushtron veprimtari prodhimi dhe shërbime në Republikën e Shqipërisë.

Standardet ndërkombëtare, europiane dhe të shteteve të tjera përshtaten dhe adoptohen si standarde shqiptare, me kusht që ato t'u shërbejnë interesave ekonomike të vendit, instalimit të teknologjive të reja dhe mënjanimit të pengesave teknike, në shkëmbimin e lirë të mallrave me vendet e tjera.

Ministrinë e institucionet e tjera qendrore, publike, detyrohen të hartojnë dhe të ndjekin zbatimin e rregullave teknike, në të gjitha fushat e veprimtarisë që mbulojnë. Rregullat teknike botohen në Fletoren Zyrtare.

#### Neni 5

Standardet Shqiptare, ose pjesë të tyre, kur gjykohet e nevojshme, përdoren si referencë në aktet ligjore ose nënligjore.

Nisma për përgatitjen e projektstandardeve merren nga personat fizikë dhe juridikë, si dhe nga vetë DPS-ja, e cila bën dhe miratimin përfundimtar të tyre.

Përfaqësuesit e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, publike, bashkëpunojnë me DPS-në, për hartimin dhe rishikimin e standardeve shqiptare, si dhe për përshtatjen dhe adoptimin e standardeve ndërkombëtare, europiane apo të një shteti tjetër.

Ministrinë e interesuara bashkëpunojnë me DPS-në, me qëllim që personat, fizikë dhe juridikë, të zbatojnë në veprimtarinë e tyre sistemet e cilësisë.

#### Neni 6

E drejta ekskluzive për publikimin dhe shitjen e standardeve i takon DPS-së, e cila mund t'ia delegojë këtë të drejtë ndonjë subjekti tjetër, publik ose privat, mbi bazën e një kontrate të lidhur me të.

Subjektet fizike dhe juridike detyrohen të blejnë pranë DPS-së ato standarde, të cilat janë përdorur si referencë në aktet ligjore e nënligjore.

### KREU III DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

#### Neni 7

Për drejtimin, organizimin dhe kontrollin e punës për standardizimin, akreditimin, certifikimin dhe sigurimin e sistemeve të cilësisë në Republikën e Shqipërisë, funksionon Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

#### Neni 8

DPS-ja është institucion qendror, publik, me qendër në Tiranë, në varësi të Këshillit të Ministrave dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

DPS-ja është institucion buxhetor.

Drejtori i Përgjithshëm emërohet e shkarkohet nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 9

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ushtron kompetencat si vijon:

- Organizimin dhe ndjekjen e procedurave të hartimit dhe të miratimit të standardeve shqiptare, certifikimit të produkteve, shërbimeve, sistemeve të cilësisë dhe të personelit.

- Ndjekjen e procedurave të standardizimit, akreditimit dhe të certifikimit, duke u mbështetur në standardet e organizmave ndërkombëtare dhe europiane, të standardizimit.

- Miratimin e standardeve shqiptare, përshtatjen dhe adoptimin e standardeve ndërkombëtare, europiane e të vendeve të tjera si standarde shqiptare, me përashtim të standardeve të fushës së telekomunikacionit, duke mbajtur parasysh marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi.

- Rishikimin e standardeve shqiptare ekzistuese.

- Akreditimin e laboratorëve të provave, organizmave certifikues dhe atyre inspektuese pasi të jetë bërë kalibrimi nga organi kompetent.

- Përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, europiane e rajonale, për fushat e

veprimtarisë, të përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, duke mbajtur parasysh marrëveshjet ndërkombe, ku shteti ynë është palë.

7. Lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organet homologe të shteteve të tjera, për informacionin, shkëmbimin e literaturës, përvojën dhe kualifikimin e specialistëve, për fushat e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, me synim lehtësimin e pengesave teknike në tregti.

8. Lidhjen e marrëveshjeve me organet homologe për njohjen e ndërsjelltë të raportanalizave të laboratorëve të akredituar, të markave të konformitetit dhe të sigurisë.

9. Nxitjen e studimeve, botimeve, përvojave e kërkimeve, që kanë të bëjnë me standardizimin dhe veprimtaritë që lidhen me të. Nxitjen dhe bashkërendimin e nismave, me karakter shkencor, teknik, zbatues dhe kulturor që kanë të bëjnë me to.

10. Mbajtjen dhe administrimin e arkivës së standardeve shqiptare e të huaja dhe kryerjen e shërbimit të informacionit, sipas nevojave të subjekteve, vendase ose të huaja, që kryejnë veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë.

11. Përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për veprimtaritë që mbulon ajo.

12. Propozimin e tarifave në Ministrinë e Financave, për shërbimet që kryen për të tretët.

#### KREU IV DEKLARIMI DHE VERIFIKIMI

Neni 10

Të gjitha produktet, proceset, apo shërbimet e tjera, që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës, mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit, për të cilat duhen respektuar aktet ligjore e nënligjore, apo rregullat teknike, përkatëse, u nënshtrohen procedurës së certifikimit të detyruar (dhënia e markës së sigurisë).

Kërkesa për këtë certifikim bëhet nga ministritë përkatëse.

Për të gjitha produktet, proceset apo shërbimet e tjera, procedura e certifikimit (dhënia e markës së konformitetit), kryhet mbi baza vullnetare, sipas akteve nënligjore.

Analizat për ekspertiza dhe për kontrollin e produkteve, që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës, mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit, kryhen vetëm në laboratorët e akredituar.

Neni 11

Deklarimi i konformitetit të një produkti, procesi apo shërbimi është i lirë të kryhet nën përgjegjesinë personale të prodhuesit ose të tregtuesit, nëpërmjet një dokumenti, kur produkti, procesi apo shërbimi nuk mbulohet me rregulla teknike ose standarde shqiptare të detyrueshme, për periudhën e caktuar në këtë ligj.

#### KREU V KUNDËRVAJΤJET

Neni 12

Shkeljet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen si kundërvajtje administrative, me gjobë nga 5 000 (pesë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Falsifikimet e rezultateve të analizave dhe të markës së sigurisë, sipas nenit 10 paragrafi i parë dhe i tretë, përbëjnë vepër penale, sipas nenit 186 të Kodit Penal.

Neni 13

1. Të drejtë e dhënes së gjobës për kundërvajtjet e përmendura në nenin 12, paragrafi i parë, e kanë punonjësit e autorizuar të DPS-së.

2. Të drejtë e kallëzimit për shkeljet e përcaktuara në nenin 12, paragrafi i dytë, e kanë respektivisht organizmat e specializuara, pranë ministrive e institucioneve të tjera qendrore, publike dhe punonjësit e DPS-së.

Neni 14

Ankimi kundër dënimive administrative, të dhëna për shkelje në nenin 6, paragrafi i parë, bëhet te Drejtori i Përgjithshëm i DPS-së, i cili përgjigjet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankimit. Kur përgjigja nuk është e kënaqshme, ankuesi, ka të drejtë t'u drejtohet organeve gjyqësore.

#### KREU VI DISPOZITA TRANSITORE

Neni 15

Standardet shqiptare të detyrueshme në fuqi e ruajnë këtë status për një periudhë deri në tre vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

DPS-ja, brenda periudhës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, deklaron emrat dhe numrat e standardeve shqiptare të detyrueshme.

Neni 16

Gjatë periudhës së përcaktuar në nenin 15 pika 1, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, publike, në bashkëpunim me DPS-në, ndjekin zbatimin e standardeve shqiptare, me status të detyrueshëm, sipas veprimitarive që mbulojnë.

KREU VII  
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Ngarkohet Keshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e mëposhtme nënligjore për zbatimin e këtij ligji, duke respektuar kompetencat e tij:

- Kodin e përgatitjes, adoptimit, miratimit dhe zbatimit të standardeve.
  - Kompetencat në fushën e standardizimit, akreditimit dhe certifikimit.
  - Shkëmbimin e informacionit për standarde dhe rregullat teknike

Neni 18

Ligji nr.7630, datë 28.10.1992, "Për standardizimin dhe cilësinë" dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, shfuqizohen.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **Shpallur me dekretin nr.2336, datë 19.3.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**